

PROKURORIA DIBËR
Nr. 785 / 30.7.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2890

Nr. _____ Prot _____

Peshkopi, më 28.07.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.78

Datë: 25.07.2023

“Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga Këshilli i Qarkut Dibër ”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Afrim Miki



BASHKISË PESHKOPI
Nr. 2890/1
01/08/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.785/1.prot.

Peshkopi, më 01.08.2023

Lënda : Per vendimin nr. 78, datë 25.07.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër

BASHKISË DIBËR

PESHKOPI


Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 31.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.78, date 25.07.2023 "Për një ndryshim fondesh në buxhetin e Qendres Kulturore Dibër akorduar nga Keshilli i Qarkut Dibër ", duke marrë në konsideratë karakteristikat e aktit administrativ, pasi vendimmarrje të kësaj natyre konsiderohet si veprime të tjera administrative vendosa :

Të miratojë në parim vendimin e sipërcituar, në kushtet e zbatimit të legjislacionit që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e financës e probleme të ngjashme me to, që duhet të jetë në koherencë me buxhetin vjetor të miratuar dhe respektimin rigoroz të disiplinës financiare.

Veprimet juridiko-financiare për zbatimin e kësaj vendimmarrje janë përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që kanë paraqitur projekt aktin dhe relacionin shpjegues mbi bazën e të cilave ka dalë vendimi nr.78, datë 25.07.2023.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 78 Datë 25 / 07 / 2023

“ Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendrës Kulturore Dibër akorduar nga Këshilli i Qarkut Dibër”

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.120 datë 22.12.2022, mbi detajimin e buxhetit të vitit 2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.19/1 prot datë 11.01.2023, i ndryshuar si dhe vendimin nr.05, datë 13.04.2023 të Këshillit të Qarkut Dibër për miratim ndryshim zërash buxhetor dhe transferim fondi për Bashkinë Dibër, (Qendra Kulturore Dibër), për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, konfirmim nga Prefekti I Qarkut Dibër me shkresën nr.476/1 prot, datë 25.04.2023, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **25.07.2023** me 16 vota pro, 3 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit të ardhur nga Këshilli I Qarkut Dibër për Qendrën Kulturore Bashkia Dibër në vlerën prej 600.000 lekë për aktivitetet e organizuara nga Qendra Kulturore Dibër, akorduar kjo vlerë nga Këshilli i Qarkut Dibër.

Të pakësohet:

Gr. 00 Tit. 1110 Kap. 5 Llog.Ekonomike 604 600.000 lekë

Të shtohet:

Gr. 00 Tit. 8220 Kap. 5 Llog.Ekonomike 602 600.000 lekë

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës), pranë Bashkisë Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datw **25.07.2023**.

Kryetare Këshilli Bashkiak
Irimi Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës
PROJEKT- V E N D I M

Nr. 17 Datë 21/07/2023

“Për një ndryshim fondesh në Buxhetin e Qendres Kulturore Diber akorduar nga Keshilli i Qarkut Diber

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Diber nr.120 datë 22.12.2022, mbi detajimin e buxhetit të vitit 2023 i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Diber me shkresën nr.19/1prot datë 11.01.2023, i ndryshuar, si dhe vendimin nr.05, date 13.04. 2023 të Keshillit të Qarkut Diber për miratim ndryshim zerash buxhetor dhe transferim fondi për Bashkinë Diber, (Qendra Kulturore Diber), për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, konfirmim nga Prefekti i Qarkut Diber me shkresën nr.476/1 prot, date 25.04.2023

Kërkojmë:

I. Miratimin e fondit të ardhur nga Këshilli i Qarkut Diber për Qendren Kulturore Bashkia Diber në vlerën prej 600.000 leke për aktivitetet e organizuara nga Qendra Kulturore Diber akorduar kjo vlerë nga Keshilli i Qarkut Diber.

Te paksohet :

GR. 00 Tit. 1110 Kap. 5 Llog. Ekonomike 604 600.000 leke

Të shtohet :

Gr.00 Tit. 8220 Kap. 5 Liog.Ekonomike 602 600.000 leke

II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Diber.

III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Diber dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Diber.

PER BASHKINE DIBER

P/S/Finances
Antike TORBA

Drejtori Ekonomik
Mensur SHEHI

Kryetari i Bashkisë
Rahim SPAHIU

P/S/Juridik
Elona LUSHA

Ne mungese dhe me porosi
Nën Kryetari i Bashkisë
Ruzhdi DEDA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT

TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur është adresuar Bashkisë Dibër nga 02.08.2023 dhe mban nga dërguesi nr 7091 prot 10682
date 02.08.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 10682 date 02.08.2023

Praktika u drejtohet për administrim:

- Znj/Z Shërbimet të Përbashkëta Bashkia
- Znj/Z
- Znj/Z
- Znj/Z

me porosinë:

Shërbimet të Përbashkëta Bashkia

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë

Shërbimet të Përbashkëta Bashkia

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

Peshkopi, më 02.08.2023

[Signature]